



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 200, Datë 24.11.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E DRAFT –  
“RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË PARAQITJES SË PLANIT TË  
INVESTIMEVE NGA OPERATORËT E TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË  
GAZIT NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e energjisë elektrike” dhe neneve 16 pika 12; 46 pika 12 dhe nenit 56 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.11.2017, mbasi shqyrtoi draftin dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “draft – Rregullores për Procedurat e Paraqitjes së Planit të Investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe të Shpërndarjes së Gazit Natyror”,

**Konstatohet se:**

- Neni 46 pika 12 i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i jep ERE-s autoritetin për të hartuar dhe miratuar “Rregulloren për procedurat e paraqitjes së planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.”
- Ky draft është hartuar në respektim të parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe harmonizuar me “Rregulloren për procedurat e paraqitjes së planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.”

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e draft - “Rregullores së procedurave të paraqitjes së planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.”
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**